



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 1589/Prot.

Tiranë, më 30.06.2025

VENDIM

Nr. 117, datë 23.06.2025

**“PËR CAKTIMIN E PËRKOHSHËM NË POZICIONIN E DREJTUESIT TË
PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM BERAT”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar
5. Arta MANDRO	Anëtar
6. Ledina RIZA	Anëtar
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Vatë STAKA	Anëtar
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

në mbledhjen e datës 23.06.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 18 e vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“Caktimin e përkohshëm në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së
Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat”**

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

PROKUROR
R-SEKTOR

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 1589 prot., datë 05.06.2025, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, me relator znj. Ledina Riza, si dhe referuar bazës ligjore të sipërpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë *(në vijim Këshilli)* është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, bazuar në parimet e pavarësisë, llogaridhënies, transparencës dhe efijencës.
2. Pozicioni i drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat është vakant që prej datës 27.03.2024, pas largimit nga detyra të ish-drejtuesit të kësaj zyre prokurorie për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar. Për rrjedhojë, ushtrimi i detyrës në fjalë nga ana e ish-drejtuesit është bërë i pamundur për një periudhë kohore të pacaktuar.
3. I ndodhur në kushtet e mësipërme, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka marrë masat e nevojshme për plotësimin e këtij funksioni me qëllim garantimin e funksionimit dhe mbarëvajtjes së punës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.
4. Plotësimi i funksionit të mësipërm është bërë nëpërmjet zbatimit të instrumentit të “Caktimit të përkohshëm” të një prokurori në këtë detyrë duke mbajtur parasysh parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
5. Me Vendimin nr. 42, datë 29.03.2024, “Për caktim të përkohshëm”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka vendosur të caktojë përkohësisht prokuroren Edina Kurti të ushtrojë detyrën si drejtuese në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, nga data 29.03.2024 deri në 28.06.2024.

Në vazhdim, Këshilli ka ndjekur të njëjtën procedurë edhe më pas, duke caktuar përkohësisht prokuroren në fjalë në të njëjtën detyrë, sipas vendimeve nr. 101, datë 27.06.2024, nr. 205, datë 30.09.2024, nr. 270, datë 23.12.2024, dhe së fundi, me Vendimin nr. 48 datë 20.03.2025, sipas të cilit, prokurorja Edina Kurti është caktuar përkohësisht si drejtuese në këtë zyrë prokurore për periudhën 29.03.2025 – 28.06.2025.

6. Së fundi, me Vendimin nr. 100, datë 23.05.2025, Këshilli ka vendosur përfundimin pa vendim përfundimtar, të procedurës të ngritjes në detyrë në pozicionin e Drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, të shpallur me Vendimin nr. 50, datë 20.03.2025, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, për arsye se në thirrjen e shpallur nga Këshilli për plotësimin e vendit vakant përmes procedurës për ngritjen në detyrë në pozicionin e drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat nuk ka pasur kandidatë që kanë shprehur interes.

7. Duke qënë se periudha e caktimit të përkohshëm për drejtuesin në detyrë në këtë zyrë të prokurorisë plotësohet në datë 28.06.2025, dhe me qëllim sigurimin e vazhdimësisë dhe mbarëvajtjes së punës është e nevojshme që, Këshilli të miratojë vendimin për caktimin e përkohshëm në detyrën në fjalë, për një periudhë 3-mujore.
8. Në nenin 59, të Ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, parashikohet se :
"1. Pozicioni i magjistratit mund të plotësohet përkohësisht, kur magjistrati me pozicion të përhershëm nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin për një periudhë jo më shumë se tre muaj, për shkak të:
 - a) caktimit në pozicione të tjera;
 - b) arsyeve të tjera të parashikuara nga ligji."
9. Ndërsa, në nenin 3, të Vendimit nr. 64, datë 15.04.2019, "Për miratimin e Rregullores "Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve", e ndryshuar, të Këshillit, përcaktohet se:
"1. Prokurori mund të caktohet përkohësisht në çdo pozicion të të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër, për të cilin përmbush kërkesat dhe kriteret e parashikuara në ligj për këtë nivel apo pozicion, në të njëjtën prokurori ku ushtron funksionin ose në një prokurori tjetër.
2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë respekton për aq sa është e mundur vullnetin e prokurorëve gjatë caktimit të përkohshëm."
10. Duke vlerësuar se rrethanat e mësipërme për caktimin e përkohshëm të drejtueses në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat nuk kanë ndryshuar, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar caktimin përkohësisht të prokurorit Edina Kurti që të ushtrojë funksionin e drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për periudhën nga data 29.06.2025 deri në 28.09.2025.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës, në nenin 59, pikat 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 184, 189 pika 1, germa "a" të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i ndryshuar, si dhe nenin 3, të Vendimit nr. 64, datë 15.04.2019, "Për miratimin e Rregullores "Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve", e ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

SEKRE

1. Caktimin e përkohshëm të prokurores Edina Kurti në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për periudhën nga data 29.06.2025 deri në 28.09.2025.
2. Për periudhën e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, prokurorja Edina Kurti të paguhet me pagën e pozicionit ku është caktuar përkohësisht.
3. Të njoftohen me këtë vendim Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat dhe prokurori Edina Kurti
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 23.06.2025.

KRYETAR
Mirela Bogdani

ZV/KRYETAR
Erind Germenji

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Erind Merkuri

ANËTAR
Erion Fejzulla